

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 58 paragrafi 1 shkronja “a” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 44 paragrafi 2 të Statutit të Komunës, nenin 16 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (KKV) Nr. 02/2022, prot. Nr. 156/2022 datë 30.06.2022 për Organizimin Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, nenin 28 paragrafi 2 i Rregullores (KKV) Nr. 03/23 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridik – OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, si dhe në bazë të kërkesës së këshillit të fshatit Bajskë datë 13.03.2024 për mbështetje financiare, lidhet kjo:

**MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI
PËR REALIZIM TË PROJEKTIT ME BASHKËFINANCIM**

Palët e marrëveshjes:

1. Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga **z. Ferit Idrizi**, Kryetari i Komunës në tekstin e mëtejme komuna,

dhe
2. Këshilli i fsh. Bajskë, përfaqësuar nga **z. Agim Hashimi**, Kryetar i Këshillit të Fshatit.

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është financimi i përbashkët i projektit “Renovimi i katit përdhes të Shtëpisë me pronar Gani Hasani nr. nga fsh. Bajskë, personal 1003042398, e cila do të shfrytëzohet për nevoja të komunitetit të fshatit Bajskë, Komuna e Vushtrrisë”, e cila gjendet në parcelën e regjistruar si njësi kadastrale P-70202003-00118-0, vendi i quajtur “Zabel/ara tu mulinit” në sipërfaqe prej 1000 m² (njëmijë metra katror), nga sipërfaqja e përgjithshme prej 6740 m², Zona Kadastrale Banjë.

Neni 2

Vlera e projektit

Vlera e përgjithshme e projektit nga neni paraprak i kësaj Marrëveshje është 9,853.00 € (nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tri euro).

Neni 3

Obligimet e përbashkëta të palëve të marrëveshjes

3.1 Palët e marrëveshjes, bazuar në paramasë dhe parallogari do të financojnë këtë projekt si në vijim:

3.1.1 Komuniteti i fshatit Bajskë do të financoj renovimin e nevojshëm të objektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje në vlerë prej 6,913.00 € (gjashtë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë euro) ndërsa,

3.1.2 Komuna e Vushtrisë do të financoj këtë projekt me mjetet buxhetore – subvencione dhe transfere të zyrës së kryetarit të komunës, në vlerë prej 2,940.00 € (dymijë e nëntëqind e katërdhjetë euro).

Neni 4

Obligimet e Komunës së Vushtrisë

4.1 Komuna e Vushtrisë do të kryej pagesën e mjeteve në shumën e cekur në pikën 3.1.2 pas dorëzimit të faturës së furnitorit si dhe raportimit me shkrim për dorëzimin e inventarit në objektin “shtëpia e komunitetit” të fsh. Bajskë të z. Nexhat Merovci zyrtar i komunës në cilësi të menaxherit /mbikëqyrësit të marrëveshjes.

4.2 Pagesa do të kryhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës, kategoria subvencione dhe transfere.

Neni 5

Obligimet e Këshillit të Fshatit Bajskë

5.1 Këshilli i fshatit Bajskë, mjetet financiare të grumbulluara në shumë prej 6,913.00 € (gjashtë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë euro) do të shpenzoj në mënyrë të pavarur në marrëveshje me punëkryesit dhe furnitorët e materialit.

5.2 Kryetari i Këshillit të fshatit do të përcjell mbikëqyrjen e implementimit të këtij projekti.

Neni 6

Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së mirëkuptimit

Komuna e Vushtrisë mban të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Këshilli i fshatit Bajskë nuk i përmbushë obligimet e veta nga kjo marrëveshje.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve eventuale

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim. Në rast të mosmarrëveshjeve çështja do të procedohet në gjykatën kompetente në bazë të ligjit në fuqi në Republikëm e Kosovës.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese pajtohen që kjo marrëveshje hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Neni 9
Nënshkrimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje nënshkruhet në tri (3) kopje origjinale — dy për komunën dhe një për këshillin e fshatit Bajskë.

Më, 11.03.2024


Komuna Vushtrri



Ferit Idrizi, Kryetar



Këshilli i Fshatit Bajskë



Agim Hashimi, Kryetar